



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

Nr. 6738/1 prot.

Tiranë, më 4.11.2025

URDHËR

Nr. 138, datë 4.11.2025

“PËR

**SHPLLJEN E PËRKTHIMIT TË NDRYSHIMEVE NË KONTRATAT QË I
REFEROHEN ENERGJISË ELEKTRIKE NË VARËSI TË NATYRËS”**

Në mbështetje të nenit 3, pika 4 dhe pika 5, të Ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.505, datë 17.07.2019 “Për miratimin e rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e përkthimit të ndryshimeve në “Kontratat që i referohen energjisë elektrike në varësi të natyrës”.
2. Ndryshimet në “Kontratat që i referohen energjisë elektrike në varësi të natyrës”, publikuar nga BSNK në Dhjetor 2024, përfshijnë kryesisht ndryshime në SNRF 9 “Instrumentet Financiare”, SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese” dhe SNRF 19 “Filialet pa Përgjegjësi Publike: Dhënia e Informacioneve Shpjeguese”.
3. Aplikimi i ndryshimeve në “Kontratat që i referohen energjisë elektrike në varësi të natyrës”, publikuar në Dhjetor 2024, kanë datë efektive më 1 Janar 2026, por lejohet zbatimi më i hershëm i tyre.
4. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

MINISTRI

Petrit Malaj

